



JORIDA RUSTEMI

DR.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

Dr. Jorida Rustemi është Përgjegjëse e Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit, Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve në Universitetin Barleti.

FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

- Shëndeti mendor dhe të drejtat e njeriut
- Vlerësimi psikologjik
- Puna klinike me adultët

EMAIL

bh.dep@umb.edu.al

BIO

Ka përfunduar me rezultate të shkëlqyera studimet universitare Psikologji Klinike, ato të thelluara pasuniversitare Master Shkencor me drejtim “Këshillim Psikologjik” pranë FSHS- UT, dhe në Psikologji Klinike pranë ESU në SHBA me mbështetje dy-vjeçare nga Programi Fulbright për Studentët e Huaj. Ka mbrojtur doktoraturën në psikologji me temë “Studim mbi stresin nga puna dhe sindromën e shterjes te psikologët shkollorë në Shqipëri”.

Prej vitit 2001 ka punuar si pedagoge pranë FSHS-UT, duke mbuluar lëndër Psikologji Sociale, Psikoterapi, Hyrje në Psikologji, Psikologji Abnormale, Psikologji Këshillimi, etj., duke vazhduar angazhimin në 2008 si Asistent Pedagoge në Departamentin e Psikologjisë dhe Edukimit Special pranë ESU për tre kurse në lëndën “Hyrje në psikologji”. Me kthimin në Shqipëri u bë pjesë e stafit të Universitetit Barleti si Pedagoge dhe Koordinatore për programet e masterit e më pas supervizore e Klinikës për Shërbim psikosocial që kishte për qëllim ofrimin e shërbimeve pa pagesë jo vetëm për studentët dhe komunitetin.

Si eksperte psikologe dhe Drejtuese e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e Torturës pranë Avokatit të Popullit ka monitoruar të gjitha institucionet ku privohet apo mund të privohet liria e individit, përfshirë këtu institucionet penitenciare, njësitë policore, spitalet psikiatrike, bazat ushtarake ku ka dhoma sigurie, qendrat ku trajtohen shtetasit e huaj, azilkërkuesit dhe viktimat e trafikut, si dhe pika të kalimit kufitar dhe mjediset ku parashikoheshin për trajtimin e migrantëve, shtëpitë e fëmijëve dhe ato për personat e moshuar, me qëllim sigurimin e një mbulimi të plotë të situatës së të drejtave të njeriut në to, parandalimit të shkeljeve, dhe hartimit të rekomandimeve konkrete mbi problematikat e konstatuara në cilësinë e shërbimit mjekësor dhe e atij psiko-social, etj.